

VENDIM
Nr. 563, datë 29.9.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 203, DATË 16.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E KULTURËS, TË PRONËS NR. 186, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 3042, QENDËR STËRVITORE”, ME VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 203, datë 16.3.2016, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve...” shfuqizohen.
 2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama